



РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА  
REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT



Në bazë të nenit 22 paragrafi 1 të Ligjit për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" Nr. 12/2019) nenit 40 paragrafi 3 të Rregullores së punës së Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit, (në tekstin e mëtejshëm: KSHPK) duke vepruar në bazë të lëndës së formuar me vet iniciativë, në seancën e 77-të, të mbajtur më datë 14.11.2022 morri,

### VENDIM

Procedura e KSHPK-së në lëndën me numër 08-5111/1, datë 15.11.2021, e formuar me vetiniciativë, për shkelje të dispozitës së nenit 82 të Ligjit për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit nga personi \_\_\_\_\_, anëtar i Bordi Drejtues i \_\_\_\_\_, NDËRPRITET.

KSHPK -ja nuk ka elemente për veprime të mëtejshme në rastin konkret.

Vendimi në formë të depersonalizuar, të publikohet në ueb - faqen e KSHPK-së brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e vendimmarrjes.

### Arsyetim

Lënda me numër 08-5111/1 të datës 15.11.2021 është formuar me vet - iniciativë.

KSHPK-ja, nga inspektimi i botimeve të Gazetës Zyrtare për vitin 2021, konstatoi se personi \_\_\_\_\_, me aktvendim me numër 14-2151/1, datë 09.02.2021, është emëruar anëtar i Bordit Drejtues të \_\_\_\_\_.

Nga këqyrja e kryer në evidencat e saj, KSHPK-ja ka konstatuar se \_\_\_\_\_ nuk ka dorëzuar fletë anketuese në KSHPK brenda afatit të përcaktuar me ligj prej 30 ditësh, duke llogaritur nga dita e emërimit në funksion.

KSHPK-ja të emëruarit i ka lëshuar urdhërpagesë kundërvajtëse me numër 08-323/2 datë 25.01.2022, për kundërvajtje të parashikuar nga neni 82 paragrafi 1 i Ligjit për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit, e dënueshme sipas nenit 109 të të njëjtin ligj.

Për shkak të faktit se pala e përmendur nuk ka vepruar në afatin e caktuar sipas urdhërpagesës për kundërvajtje, KSHPK-ja ka paraqitur kërkesë për inicimin e procedurës për kundërvajtje në Komisionin për Kundërvajtje në KSHPK.

Komisioni për kundërvajtje me aktvendim numër 14-2873/4 të datës 03.08.2022, autori \_\_\_\_\_ e shpalli përgjegjës për kundërvajtjen që i ngarkohej dhe i shqiptoi sanksion kundërvajtës - gjobë në shumë prej 400 euro në denarë.

Duke pasur parasysh tē theksuarēn e mēsipërme, Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit vendosi si në dispozitēn e këtij vendimi.

Përgatiti: A.Ç.  
Miratoi: Mr. Shemshi Sallai

KOMISIONI SHTETËRORË  
PËR PARANDALIMIN E KORRUPSIONIT  
KRYETARE,  
Biljana Ivanovska

